



Datë: 06.02.2026
Numër Protokolli: 704/2026

A.nr.123/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.123/2026, të datës 02.02.2026, të parashtruar nga ankuesi, B.K, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.02.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.123/2026, të datës 02.02.2026, të parashtruar nga ankuesi, B.K.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, B.K, (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesi), më datë 02.02.2026, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar po të njëjtën datë nën shenjë A.nr.123/2026, kundër Vendimit A.nr.1634/2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes së cilit është anuluar procedura e rekrutimit me numër reference RN00017394, pozita e punës “Zyrtar i Lartë për Kimikate” në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në *tekstin e mëtejme referuar*: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit ka gjetur se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se – Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 24.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017394, Grupi i përgjithshëm i mjedisit, pozita “Zyrtar i Lartë për Kimikate” në Divizionin e Lejeve dhe Licencave

Mjedisore në Departamentin e Mbrojtjes së Mjedisit, numri i kërkuar një (1), me afat aplikimi nga data 25.03.2025 deri më datë 23.04.2025.

Tutje, sipas provave materiale të çështjes del së në konkursin përkatës të punësim ka aplikuar edhe ankuesi, i cili sipas Njoftimit të datës 31.07.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i njëjti është shpallur si kandidat fitues për pozitën përkatëse me 92.4. pikë, duke u renditur i pari në listën fituese.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1634/2025, të datës 28.08.2025, të parashtruar nga kandidatja A.Z me Vendimin A.nr.1634/2025, të datës 05.12.2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuses, duke anuluar në tërësi procedurën e pranimi me numër reference RN00017394, për Grupi i përgjithshëm i mjedisit, pozita “Zyrtar i Lartë për Kimikate” në Divizionin e Lejeve dhe Licencave Mjedisore në Departamentin e Mbrojtjes së Mjedisit.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit A.nr.1634/2025, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë Vendimin me numër 148/26 të datës 16.01.2026 me të cilin anulohet procedura e rekrutimit me numër të referencës RN00017394, për pozitën “Zyrtar i Lartë për Kimikate” në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Pas publikimit të Vendimit me numër 148/26 të datës 16.01.2026, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Vendimin me numër A.nr.1634/2025, të datës 05.12.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Vendimin me numër protokolli Nr.148/26, të datës 16.01.2026, të Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Andaj, nisur nga gjendja e fakteve si me sipër, Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 104 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”**, vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje, mbi faktin se Këshilli me vendim përfundimtar ka vendosur lidhur me ligjshmërinë e procedurës së pranimi me numër reference RN00017394, rrjedhimisht duke e anuluar të njëjtën si të paligjshme.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.123/2026

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, B.K;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së